



MODELET E PRAKTIKAVE TË MIRA PËR PJESËMARRJEN E FËMIJËVE NË VENDIMMARRJE



Save the Children



Sweden
Sverige

RAPORT VLERËSUES

Nëntor 2021

TITULLI	Modelet e praktikave të mira për pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje
DATA E RAPORTIT	Nëntor 2021
LLOJI I RAPORTIT	Raport vlerësues
AUTOR	Driton Zeqiri
EMAIL	driton.zeqiri@gmail.com
EMRI I PROJEKTIT	Fuqizimi i OSHC-ve rajonale 2017-2021
UDHËHEQËS I PROJEKTIT	Veton Kryeziu
KOHËZGJATJA E PROJEKTIT	5 vite
FUSHAT TEMATIKE	Qeverisje me të drejtat e fëmijës
DONATORI	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida)

Ky raport është financuar nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësia për përmbajtjen i takon tërësisht krijuesit. Qeveria e Suedisë nuk ndan domosdoshmërisht pikëpamjet dhe interpretimet e shprehura.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e akronimeve	5
Përmbledhje e përgjithshme	7
Historiku	13
Fushëveprimi i vlerësimit.....	18
Metodologjia.....	19
Gjetjet.....	20
Rekomandimet	30

LISTA E AKRONIMEVE

AKRONIMI	PËRSHKRIMI
FK	Fletënotimi Komunitar
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KLUBI DX	Klubi për të Drejtat e Fëmijës
LGBTI	Lezbikë, Gej, Biseksual, Transgjjinor, Transseksual ose Interseksual
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
CRC	Child Rights Centre
ROR	Respect our Rights
SCNK	Save the Children në Kosovë
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë





PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Projekti “Fuqizimi i OSHC-ve Rajonale 2017-2021”, i zbatuar nga Save the Children në Kosovë në bashkëpunim me Save the Children Suedi dhe i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) është replikim rajonal i projektit simotër në Kosovë, që ka për synim të sigurojë mbrojtjen e fëmijëve përmes themelimit të sistemeve reaguese të Mbrojtjes së Fëmijëve (MF) dhe përmes mbështetjes së sistemeve dhe mekanizmeve të Qeverisjes me të Drejtat e Fëmijëve (CRC) që do të themelohen në rajon, përkatësisht në Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Këto përpjekje reflektohen në objektivat kryesore të projektit:

- Fëmijët mbrohen përmes një sistemi reagues të mbrojtjes së fëmijëve, të mbështetur me legjislacion të fuqishëm.
- Ekzistojnë sisteme, struktura dhe mekanizma për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në vendet e programit dhe qeveritë janë duke i përfshirë zërat e OSHC-ve dhe të fëmijëve në këto procese.

E drejta e fëmijëve për të marrë pjesë në vendimmarrje në të gjitha çështjet me ndikim në jetën e tyre është një parim kushtetues dhe ligjor i vendosur që moti dhe një element kritik i ndërtimit të një jete më të mirë. Prandaj, fëmijët duhet të përfshihen në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e tërë legjislacionit, politikave, shërbimeve dhe programeve përkatëse që kanë ndikim në jetën e tyre dhe në nivel të komunitetit, në nivel lokal, kombëtar dhe global. Shoqëria civile ka rol thelbësor në mbështetjen e fëmijëve në këto procese. Pandemia sigurisht ka ndikuar në punën e Save the Children dhe akterëve të shoqërisë civile, duke përfshirë fëmijët, në afat më të gjatë. Ishte njëkohësisht sfidë dhe mundësi për të gjetur mënyra të reja të përfshirjes së fëmijëve në sistemet e vendimmarrjes në vendet e programit drejt angazhimit më të sigurt, gjithpërfshirës, domethënës dhe sistematik në të gjitha proceset e vendimmarrjes.

Save the Children në Kosovë kërkoj një vlerësim për modelet e praktikave më të mira në pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje, në kuadër të projektit “Fuqizimi i OSHC-ve Rajonale 2017-2021”.

Mbledhja e të dhënave u bë përmes rishikimit të dokumenteve të projektit dhe intervistave të thelluara, duke siguruar mbledhje të kënaqshme të të dhënave nga burime të ndryshme. Madhësia e mostrës ishte 15 pjesëmarrës. Hulumtimi përfshiu OSHC-të që punojnë në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.

Hulumtimi do t’i eksplorojë modalitetet, praktikat, barrierat (formale dhe joformale) dhe mundësitë për pjesëmarrje domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte të fëmijëve në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Ukrainë, Serbi dhe Moldavi gjatë zbatimit të projektit “Fuqizimi i OSHC-ve Rajonale 2017-2021”.

Kjo me qëllim të informimit se si Save the Children dhe partnerët mund ta përmirësojnë dhe përshtasin mbështetjen e tyre për pjesëmarrjen e fëmijëve në proceset lokale, vendore dhe globale të vendimmarrjes dhe monitorimit. Poashtu, hulumtimi ka shqyrtuar edhe ndikimin – pozitiv dhe negativ – të pandemisë COVID-19 në pjesëmarrjen e fëmijëve, duke përfshirë pjesëmarrjen online dhe çfarë do të thotë kjo në afat më të gjatë për punën tonë në pjesëmarrjen e fëmijëve.

Kjo analizë do t’i identifikojë praktikat më të mira që duhet të shfrytëzohen në mënyrë që të jepen rekomandime specifike për t’i përmirësuar proceset dhe platformat për pjesëmarrje më sistematike, domethënëse dhe gjithpërfshirëse të fëmijëve, duke përfshirë integrimin e zërave të fëmijëve në marrjen e vendimeve dhe rekomandimeve.

Në këtë raport janë përmbledhur praktikat më të mira për ngritjen e kapaciteteve të fëmijëve për të ushtruar ndikim në vendimmarrje në Kosovë, Moldavi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Ukrainë duke përfshirë rekomandime për mënyrat si mund të përdoren këto praktika për të rindërtuar sisteme më të mira të pjesëmarrjes së fëmijëve.

Ky hulumtim mbulon tema siç janë:

- Përmirësimet kryesore në pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje si rezultat i këtij projekti.
- Praktikrat më të mira në rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje.
- Faza e legjislacionit për Qeverisjen me të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Barrierat ndaj pjesëmarrjes domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte të fëmijëve në vendimmarrje në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Mundësitë për pjesëmarrje domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte të fëmijëve në vendimmarrje në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Ndikimi i COVID-19 në pjesëmarrjen e fëmijëve, duke përfshirë pjesëmarrjen online, dhe implikimet afatgjata për pjesëmarrjen e fëmijëve në të ardhmen.
- Rekomandime për përforcimin e proceseve dhe platformave për pjesëmarrje më sistematike, domethënëse dhe gjithpërfshirëse të fëmijëve në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut.



Më poshtë janë paraqitur gjetjet kryesore, të ndara sipas temave.

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, përmirësimet kryesore në pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje, si rezultat i ndërhyrjes së projektit, dhe praktikat më të mira për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje janë:

- Themelimi dhe funksionalizimi i grupeve avokuese të fëmijëve;
- Qasja pjesëmarrëse – përfshirja e fëmijëve në çdo fazë të procesit/planifikimit;
- Qasja gjithpërfshirëse – përfshirja e prindërve, ofruesve të shërbimeve dhe institucioneve në grupet avokuese të fëmijëve;
- Fletënotimi Komunitar – dhënia e komenteve vlerësuese për ofruesit e shërbimeve dhe pjesëmarrja në proceset vendimmarrëse për adresimin e çështjeve të ngritura;
- Planet e veprimit – hartimi i planeve të veprimit në nivel lokal dhe kombëtar;
- Themelimi dhe funksionalizimi i grupit “Respect Our Rights” (ROR) në nivel vendor;
- Asambletë Komunale të Fëmijëve – krijimi i infrastrukturës ligjore që këto grupe të jenë funksionale dhe të qëndrueshme;
- Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në monitorimin e Strategjive/Planeve të Veprimit që prekin të drejtat e fëmijëve;
- Zhvillimi i kapaciteteve të grupeve të fëmijëve në mënyrë që ata të marrin pjesë në vendimmarrje në mënyrë efektive;
- Sigurimi i mbështetjes për grupet e fëmijëve në nismat e tyre avokuese nga OSHC të ndryshme;
- Themelimi dhe funksionalizimi i platformave të ndryshme të pjesëmarrjes, duke përfshirë platformat elektronike;
- Financimi i projekteve të zhvilluara nga fëmijët;
- Hartimi i udhëzimeve për pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje.

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, si rezultat i këtij projekti dhe zhvillimeve të tjera pozitive, që nga viti 2017 legjislacioni për Qeverisjen e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut është përmirësuar dukshëm:

- Në Kosovë, Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës i cili ka hyrë në fuqi në 2020 dhe është hartuar Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve (2019-2023).
- Në Serbi, është miratuar Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Dhunës dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna për periudhën 2020-2023, e shoqëruar me Planin e Veprimit për 2020 dhe 2021.
- Në Maqedoninë e Veriut, në vitin 2019, është miratuar Ligji për Edukimin Primar, i cili ka përmirësuar pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje brenda shkollës duke bërë obligative që në shkollë të themelohet Parlamenti i Fëmijëve dhe Ombudspersoni për fëmijë.
- Në të gjitha vendet ende ka nevojë për përforsim të mëtejshëm të mekanizmave në nivel lokal dhe kombëtar për të siguruar që janë duke u respektuar të drejtat e fëmijëve dhe që është e garantuar mirëqenia e tyre.

Sipas të intervistuarve, barrierat ndaj pjesëmarrjes domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte të fëmijëve në vendimmarrje në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut përfshijnë:

- Shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve nuk reagojnë në mënyrë të duhur ndaj nevojave të fëmijëve, për shkak të mungesës së kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për të komunikuar në mënyrë efektive;
- Mungesa e vullnetit politik të ofruesve të shërbimeve për t'i përfshirë fëmijët në vendimmarrje;
- Fëmijëve iu mungojnë informatat për mënyrat se si mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në vendimmarrje;
- Disa grupe të fëmijëve ende mbesin të papërfaqësuar mjaftueshëm në organet e vendimmarrjes, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas;

- Institucionet nuk i kanë kapacitetet dhe mjetet e mjaftueshme për të komunikuar në mënyrë efektive me fëmijët, për t'i mbledhur këndvështrimet e tyre dhe për ta dëgjuar zërin e tyre në mënyrë efektive.

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, ndikimi i COVID-19 në pjesëmarrjen e fëmijëve, duke përfshirë pjesëmarrjen online dhe implikimet afatgjata për pjesëmarrjen e fëmijëve në të ardhmen, është vërejtur në fushat e mëposhtme:

- Institucionet shtetërore, duke përfshirë ofruesit e shërbimeve, nuk kanë forma dhe metodologji efektive për komunikim me fëmijët përmes platformave online;
- Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas janë ndikuar nga COVID-19 sa i përket pjesëmarrjes online më së shumti nga grupet më të cenueshme;
- Mungesa e kontaktit të fëmijëve me bashkëmoshatarët e ka thelluar më shumë izolimin social të fëmijëve dhe e ka penguar pjesëmarrjen e tyre;
- COVID-19 ka ndikuar në zvogëlimin e kontakteve sociale dhe mundësive që fëmijët t'i ndajnë mendimet e tyre me vendimmarrësit.





HISTORIKU

Kosova ballafaqohet me nivelet më të larta të varfërisë në Evropën Juglindore, me një shkallë të varfërisë së fëmijëve prej 20.7%. Ndikimet e COVID-19 në ndjeshmërinë e fëmijëve dhe në varfëri ka gjasa të jenë të konsiderueshme, pasi që veprimtaria ekonomike në Kosovë është ndalur dhe remitancat kanë rënë. Ka të ngjarë që një numër i konsiderueshëm i njerëzve do ta humbin vendin e punës, sidomos ata me kontrata për periudhë të caktuar, punëtorët sezonalë dhe ata që punojnë në ekonominë joformale. Kosova ka një sektor të gjerë të ndërtimitarisë, që është veçanërisht i ndjeshëm sepse është burim i rëndësishëm i të ardhurave për popullsinë e varfër që jeton në zona urbane dhe grupet e cenuara. Madje, projeksionet sugjerojnë që 57,000-148,000 njerëz mund të bien në varfëri, ndërsa numri i popullsisë në varfëri të mesme mund të tkurret deri në 100,000 njerëz.

Kjo është e barabartë me rritjen e shkallës së varfërisë prej 4-10 %. Edhe pse ndihma sociale është burim i rëndësishëm i të ardhurave për të varfërit (numri i të cilëve shkoi deri në 15% në vitin 2017) dhe do t'i mbrojë të varfërit deri në një masë nga kriza, më shumë se gjysma e njerëzve që janë duke rënë në varfëri aktualisht nuk përfitojnë nga programi i ndihmave sociale. Do të jetë e nevojshme të zgjerohet programi i ndihmave sociale dhe mundësisht edhe kufiri i programit të transfereve të parave të gatshme për t'i lehtësuar efektet e rënies së të ardhurave (Save the Children, 2020). Trendet kryesore në Kosovë reflektojnë progres të ngadaltë në adresimin e nevojave të fëmijëve përmes një qasjeje holistike dhe koordinimit të dobët të mekanizmave në nivel lokal dhe kombëtar për të mundësuar qasjen e fëmijëve në shërbime cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të integruara. Korniza ligjore garanton mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve, në përputhje me mekanizmat dhe agjendat ndërkombëtare.

Pavarësisht se kornizat ligjore janë kryesisht të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe respektojnë gjuhën e KDF-së, ekzistojnë

boshllëqe informatash për sa i përket monitorimit të performancës së institucioneve shtetërore (sikurse Raportimi Alternativ për zbatimin e KDF-së), e matur kundrejt standardeve të tilla.

Ligji i ri për Mbrojtjen e Fëmijës promovon interesin më të mirë të fëmijës dhe ndalimin e ndëshkimit trupor në të gjitha mjediset, si dhe mandaton organet përkatëse qeverisëse që të iniciojnë veprime të koordinuara për zbatimin e ligjit në nivel lokal. Ky ligj synon të mbështesë krijimin e mandateve të qarta dhe llogaridhënëse ndërmjet bartësve të detyrave në nivel kombëtar dhe lokal. Për t'iu përgjigjur sfidave vendore dhe ndërkombëtare, por edhe në përputhje me detyrimet e shteteve palë të përcaktuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), Kosova ka vënë në zbatim Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2009-2013).

Megjithëse është arritur progres në fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje, ende mbetet shumë punë për tu bërë në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e plotë e fëmijëve.

Serbia vazhdon të ketë shkallë të lartë të njerëzve që jetojnë në varfëri absolute me 10%, ndërsa Serbia Jugore dhe Jugperëndimore mbeten rajonet më të privuara ekonomikisht dhe socialisht. Shkalla e papunësisë është 20.8% dhe hendeku midis ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore të kualifikuar që nuk korrespondon domosdoshmërisht me nevojat e ekonomisë. Për sa i përket legjislacionit për të drejtat e fëmijëve, Serbia ende nuk ka Ligjin gjithëpërfshirës për të Drejtat e Fëmijës dhe një ndalim të qartë për ndëshkimin trupor të fëmijëve në mjedisin familjar. Kjo rezulton në mos sinkronizimin e përpjekjeve që synojnë përmirësimin e pozitës së fëmijëve në Serbi. Miratimi i këtyre ligjeve është i rëndësishëm, pasi ky ishte një rekomandim i dhënë Serbisë nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve në dy cikle, dhe nga Rishikimi i Tretë Universal Periodik i fundit i OKB-së i Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut. Në vitin 2018, një grup pune i formuar në kuadër të Ministrisë së Punës, Punësimit, Veteranëve dhe Çështjeve Sociale, përpiloi Projektligjin Paraprak për të Drejtat e Fëmijës dhe Mbrojtësin e të Drejtave të Fëmijës. Pandemia e COVID-19 ka përkeqësuar më tej pozitën e fëmijëve në Serbi, e cila reflektohet veçanërisht tek fëmijët nga grupet më të cenueshme - fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët migrantë, fëmijët romë, fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, fëmijët me HIV/AIDS, fëmijët që i përkasin popullatës LGBTI dhe fëmijë të tjerë në nevojë.

Në vetëm dy dekada, **Maqedonia e Veriut** ka bërë përparim të konsiderueshëm në reformat sociale dhe ekonomike, duke u vendosur si një vend me të ardhura të mesme të larta. Varfëria dhe papunësia vazhdojnë në vend. Mbi një e katërta e popullsisë jeton nën kufirin e varfërisë dhe shkalla e papunësisë në vend është rreth 30 për qind. Maqedonia e Veriut e ratifikoi Konventën e KB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) në 1993 dhe në 2003, duke miratuar dy protokollet e saj opsionale (Protokolli Fakultativ i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur; Protokolli Fakultativ Konventës për të Drejtat e Fëmijës, për prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë). Në kuadër të angazhimeve të saj, Maqedonia e Veriut krijoi një kornizë legjislative për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për të siguruar që fëmijët të mbrohen, të mësojnë dhe të lulëzojnë. Kjo kornizë përbëhet nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Ligji për Familjen, Ligji për Mbrojtjen Sociale, Ligji dhe Regjistri i të dënuarve për shkelje seksuale, Ligji për drejtësinë për fëmijët dhe Ligji për parandalimin, parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Megjithatë, kapacitetet institucionale dhe efektiviteti i mekanizmave shtetërorë për zbatimin e dispozitave legjislative mbeten të ulëta. Raporti mbi KDFK shprehu shqetësime se legjislacioni kombëtar nuk përputhet plotësisht me parimet dhe dispozitat e Konventës dhe se zbatimi i tij mbetet i dobët.

Ukraina po përballet me sfidat e saj më serioze që nga arritja e pavarësisë në 1991. Konflikti në lindje detyroi më shumë se një milion njerëz të linin shtëpitë e tyre për të shpëtuar jetën e tyre. Për më tepër, COVID-19 përkeqësoi situatën e fëmijëve dhe familjeve që jetojnë në situatë të cënueshme si pasojë e humbjes së disa mundësive për të fituar dhe probleme të tjera sociale, duke përfshirë mungesën e qasjes në shërbimet arsimore dhe rekreative për fëmijët. Aktualisht Ukraina po kalon reforma legjislative duke përfshirë decentralizimin, policinë, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Ndërkohë, kriza ekonomike dhe konflikti i armatosur sërish kanë lënë mënjanë sferën e të drejtave të fëmijëve. Megjithëse organet qeveritare vazhduan punën e tyre, duke përfshirë hartimin e projektligjeve dhe rregulloreve të tjera, procesi i reformës legjislative ngeci si rezultat i pandemisë. Pavarësisht ndalimit ligjor ekzistues për të gjitha format e dhunës ndaj fëmijëve, qëndrime të tilla mbeten normë për një pjesë të madhe të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, mekanizmat e vendosur për të luftuar dhunën dhe çdo lloj diskriminimi nuk zbatohen në praktikë.

Si rezultat, trajtimi degradues ndaj fëmijëve në shkollë dhe në mjedisin familjar mbetet ende një praktikë e përditshme.

Pavarësisht se **Moldavia** ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF) për më shumë se 20 vjet, jo të gjitha të drejtat e fëmijëve respektohen, mbrohen dhe përmbushen. Një nga faktorët themelorë pas situatës së vështirë për fëmijët është i natyrës ekonomike, ku të ardhurat e ulëta dhe shkalla e lartë e papunësisë vënë stres të mëtejshëm mbi familjet me fëmijë dhe ku ka më pak fonde në dispozicion për shpenzimet publike. Përveç kësaj, paqëndrueshmëria politike dhe përkeqësimi i sistemit publik kanë një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në situatën e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi dhe për fëmijët nga shtresat e lëna anash në veçanti. Nga ana tjetër, ka reforma të dukshme, duke përfshirë sistemin arsimor dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilat ofrojnë kornizën e duhur për zhvillim të mëtejshëm. Sfida kryesore për ndryshim të qëndrueshëm është hendeku i zbatimit. Meqenëse strukturat janë krijuar veçanërisht në nivel kombëtar, megjithatë, mungojnë proceset për të transformuar ligjet dhe politikat në praktikë të institucioneve dhe profesionistëve, për t'i bërë standardet kombëtare realitet për fëmijët.

Edhe pse është bërë progres në fushën e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje, mbetet ende shumë për të bërë në mënyrë që të sigurohet një pjesëmarrje e plotë e fëmijëve. Sipas gjetjeve tona, janë bërë përpjekje të rëndësishme në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut për të adresuar çështjen e pjesëmarrjes së fëmijëve.



Programi i fuqizimit të OSHC-ve në Kosovë dhe Rajon është bazuar në Kornizën Logjike si në vijim::

Objektivat kryesore

Fëmijët mbrohen përmes një sistemi reagues të mbrojtjes së fëmijëve, të mbështetur me legjislacion të fuqishëm.	Ekzistojnë sisteme, struktura dhe mekanizma për zbatimin e të drejtave të fëmijëve në vendet e programit dhe qeveritë janë duke i përfshirë zërat e OSHC-ve dhe të fëmijëve në këto procese.
---	--

Objektivat specifike

Themelimi dhe rregullimi i një mekanizmi për pjesëmarrjen domethënëse të fëmijëve në nivel lokal dhe kombëtar për monitorimin e të drejtave të fëmijëve;	Përdoren praktika të dialogut të llogaridhënies sociale për ta përmirësuar qasjen në shërbime cilësore për mbrojtjen dhe arsimimin e fëmijëve;
Fuqizimi i OSHC-ve për të avokuar për ngritjen e llogaridhënies së sektorit privat lidhur me të Drejtat e Fëmijëve;	OSHC-të kanë kapacitete teknike dhe organizative për t'u angazhuar me fëmijët në monitorimin dhe avokimin e të Drejtave të Fëmijëve;
OSHC-të kanë kapacitete për t'i përdorur dhe promovuar mjetet e llogaridhënies sociale për të mundësuar krijimin e sistemeve reaguese duke i marrë parasysh prioritetet e fëmijëve;	OSHC-të kanë kapacitete për t'i përdorur dhe promovuar mjetet e llogaridhënies sociale për të mundësuar krijimin e sistemeve reaguese duke i marrë parasysh prioritetet e fëmijëve;
Grupet e udhëhequra nga fëmijët kanë kapacitete që e mundësojnë pjesëmarrjen e tyre domethënëse në proceset e vendimmarrjes;	Stafi që punon me fëmijët dhe prindërit/kujdestarët e tyre (duke përfshirë psikologët për fëmijë, mësimdhënësit, punëtorët shëndetësorë dhe socialë, policinë dhe të tjerët) kanë kapacitete;
Fëmijët, familjet dhe ofruesit e shërbimeve e kuptojnë dhe marrin pjesë në mënyrë aktive në dialogun e llogaridhënies sociale.	



FUSHËVEPRIMI I VLERËSIMIT

Në përputhje me objektivat e projektit “Fuqizimi i OSHC-ve Rajonale 2017-2021” dhe fokusin e tij për fuqizimin e kapaciteteve të OSHC-ve dhe fëmijëve për të ushtruar ndikim në vendimmarrje, Save the Children në Kosovë inicioi një vlerësim me qëllimin për t’i ofruar informatat e mëposhtme:

- Të hartëzohen modalitetet dhe praktikrat e ndryshme të pjesëmarrjes së fëmijëve të zhvilluara si pjesë e projektit në vendet e programit.
- Të identifikohen barrierat, formale dhe joformale, dhe të ndahen shembuj të praktikave më të mira të pjesëmarrjes së sigurt, gjithpërfshirëse dhe domethënëse të fëmijëve (duke përfshirë fëmijët nga grupet më të ndjeshme) në vendet e programit.
- Të analizohen elementet dhe proceset e nevojshme në nivel lokal dhe kombëtar për ta përkrahur angazhimin e fëmijëve me mekanizmat shtetërorë të të drejtave të fëmijëve.
- Të shqyrtohen mundësitë dhe sfidat e pjesëmarrjes së fëmijëve përmes platformave online, duke përfshirë pjesëmarrjen në nivel vendi, si qasje e mundshme afatgjate për pjesëmarrje, duke i marrë parasysh të gjitha masat e nevojshme për pjesëmarrje të sigurt.
- Të jepen rekomandime për Save the Children, OSHC-të partnere dhe akterët e tjerë për ta rritur pjesëmarrjen e sigurt, domethënëse dhe gjithpërfshirëse të fëmijëve në vendimmarrje.



METODOLOGJIA

Për këtë vlerësim janë konsultuar burime të të dhënave primare dhe sekondare. Sa iu përket burimeve të të dhënave primare, hulumtimi është mbështetur në metodologji kuantitative dhe kualitative. Mbledhja e të dhënave është bërë përmes rishikimit të dokumenteve të projektit dhe intervistave të thelluara, duke siguruar mbledhje të kënaqshme të të dhënave nga burime të ndryshme.

Metodologjia është zgjedhur për t'i përmbledhur saktësisht dhe me sukses të gjitha të dhënat e nevojshme për fushëveprimin e vlerësimit të projektit, si dhe, siç u tha më sipër, për të siguruar mbledhje të të dhënave nga burime të ndryshme. Metodologjia është zgjedhur poashtu në mënyrë që të mund të zbatohet me kohë, duke pasur parasysh masat vendore kundër COVID-19.

Rishikimi i të dhënave sekondare – fillimisht është bërë një analizë intensive dhe gjithpërfshirëse e të dhënave sekondare. Janë rishikuar të gjitha raportet e vlerësimeve dhe raportet e Monitorimit & Vlerësimit të prodhuara nga SCiK në mënyrë që të kuptohej progresi i projektit drejt objektivave dhe synimeve të tij. Është bërë rishikimi i rezultateve në lidhje me treguesit sipas Kornizës Logjike, rishikimi i vlerësimeve fillestare dhe afatmesme dhe raportet e hulumtimeve të tjera të prodhuara nga SCiK, me mbështetjen e Save the Children Suedi dhe me financim nga Sida. Metodologjia poashtu ka përfshirë rishikimin e literaturës së jashtme relevante në lidhje me situatën e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimarrje në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Vëmendje e veçantë iu kushtua hulumtimit të ndryshimeve në infrastrukturën ligjore dhe nivelit të zbatimit të tyre në këto vende.

Intervistat e thelluara – në bashkëpunim me ekipin e SCiK-së, konsulenti hartoi një udhëzues për intervista me qëllim që të gjitha pyetjet të jenë relevante dhe cilësore. Intervistat u administruan përmes platformës elektronike Zoom. Gjithsej 15 persona/OSHC morën pjesë në hulumtim. OSHC-të e përfshira në hulumtim ishin nga Kosova, Moldavia, Ukraina, Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Për të dhënat kualitative janë mbledhur informata nga burime të ndryshme, duke i krahasuar raportet e SCiK-së me analiza të tjera të mbështetura nga programet e financuara nga Sida. Të gjitha aktivitetet e mbledhjes së të dhënave u zhvilluan brenda 27-30 shtator 2021.

Në përputhje me pyetjet hulumtuese, për këtë hulumtim është përdorur procedura e qëllimshme e përzgjedhjes së mostrës. Pjesëmarrësit e përfshirë në hulumtim ishin përfaqësues të OSCH-ve që kanë qenë të përfshira drejtpërdrejt në zbatimin e projektit. Raporti përmban gjetje, përfundime dhe rekomandime mbi fushën e hulumtimit. Të gjitha gjetjet janë grupuar sipas pyetjeve hulumtuese të paraqitura në Fushëveprimin e Vlerësimit.





GJETJET

I. Përmirësimet kryesore në pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje si rezultat i ndërhyrjeve të projektit dhe praktikave mira për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje.

Projektet e OSHC-ve të mbështetura nga ky program i Save the Children në Kosovë, kanë zbatuar Fletënotimin Komunitar si mjet i llogaridhënies sociale, synon të adresoj nevojat e fëmijëve në sektorë të ndryshëm si edukimi, shëndetësia dhe mirëqenia. Në të gjitha këto procese, fëmijët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë akterë kyç në ofrimin e komenteve vlerësuese për ofruesit e shërbimeve dhe pjesë e vendimmarrjes së institucioneve për adresimin e çështjeve të ngritura. Po ashtu, fëmijët me aftësi të kufizuara janë pjesë e grupeve punuese që e monitorojnë zbatimin e planeve të veprimit të nxjerra nga këto procese. Duhet të ceket se fëmijët e kanë përfaqësuar zërin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivel lokal, kombëtar, regjional dhe ndërkombëtar dhe që disa prej tyre tani janë angazhuar në grupe të tjera të avokimit dhe monitorimit të të drejtave të fëmijëve si grupi ROR dhe Asambletë Komunale të Fëmijëve.

Në projektet e OSHC-ve në **Kosovë** janë themeluar grupet avokuese të fëmijëve, përmes të cilave janë ngritur dhe fuqizuar dukshëm ndërgjegjësimi dhe kapacitetet e fëmijëve për të avokuar për të drejtat e tyre, duke e mbështetur përfaqësimin e fëmijëve si dhe duke e rritur pjesëmarrjen në vendimmarrje. Disa projekte në Kosovë, përveç me fëmijët, paralelisht kanë punuar edhe me prindërit, ofruesit e shërbimeve dhe institucionet në nivel lokal dhe kombëtar për ta rritur ndërgjegjësimin lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje.

Grupet formale të fëmijëve kanë punuar për t'i ngritur kapacitetet e tyre për të reaguar më mirë ndaj nevojave të bashkëmoshatarëve të tyre dhe, duke i shfrytëzuar njohuritë dhe kapacitetet e fituara, vazhdimisht avokojnë për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve. Në dy komuna të Kosovës është promovuar modeli i komunës mike për fëmijët. Si pjesë e këtyre proceseve, janë miratuar protokollet për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve në nivel lokal. Sigurisht, këto protokolle përqendrohen dukshëm në përmirësimin e pjesëmarrjes në nivel lokal.

Në **Maqedoninë e Veriut**, në vitin 2020, është themeluar një Këshill i Fëmijëve, si organ këshillues i OSHC-së 'Megjashi', si organizatë partnere e SCiK në kuadër të këtij programi. Sa iu përket aktiviteteve, fëmijët anëtarë të Këshillit të Fëmijëve janë trajnuar për pjesëmarrjen e fëmijëve, kanë marrë pjesë në procesin e shkrimit të raportit për situatën e të drejtave të fëmijëve në Maqedoninë e Veriut, si dokument që iu dorëzua përfaqësuesve të KDF në OKB nga vetë fëmijët në Sesionin e 88-të KDF-së së OKB-së. Në 2020, Qeveria e Serbisë e miratoi Strategjinë për Parandalimin e Dhunës dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna për periudhën 2020-2023, me një Plan Veprimi për vitet 2020 dhe 2021. Gjatë procesit të hartimit të saj, u mbajtën dy dëgjime publike ku përveç organizatës partnere të programit Child Rights Centre (CRC) morën pjesë edhe Klubi DX (Klubi për Të Drejtat e Fëmijës) i cili është një grup jo-formal i fëmijëve i mbështetur nga CRC përmes programit të Save the Children të financuar nga Sida. Si rezultat, u përfshinë disa prej propozimeve kryesore të fëmijëve për përmirësimin e kësaj Strategjie. Përfaqësuesit e CRC në Serbi dhe Klubit DX morën pjesë aktivisht në dëgjimet publike dhe dhanë propozimet e tyre për përmirësimin e Strategjisë. Raporti për vetëdijësimin e fëmijëve për rreziqet e abuzimit dhe shfrytëzimit seksual përmes internetit dhe formave të mbrojtjes të disponueshme në Serbi u përgatit nga CRC, Klubi DX dhe fëmijët nga parlamentet e shkollave në 3 shkolla në Beograd – dhe u dërgua në 2018. Aktivitetet u planifikuan në përputhje me një varg objektivash metodologjike të përshtatura për moshën e fëmijëve (13-17 vjeç) të anketuar dhe të përfshirë në përgatitjen e raportit. Ky proces mori parasysh kushtet specifike të grupeve të cenueshme – fëmijët nga shumë familje në situata të ndjeshme, si nga familjet rome dhe fëmijët emigrantë nga familje të varfëra (në bashkëpunim me një nga shkollat e përfshira). Punëtoritë tjera me fëmijë përfshinë zhvillimin e kuizit Kahoot për temën që ishte përgatitur nga Klubi DX.

Ky proces i ndihmoi fëmijët të mësojnë për Konventën e Lanzarotit dhe mekanizmat e disponueshëm të mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha format e dhunës, duke u përqendruar në shfrytëzimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve përmes internetit, për punën e Komitetit të Lanzarotit, si dhe për mundësinë e pjesëmarrjes në mënyrë domethënëse në proceset e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Në vitin 2021, CRC mori një letër falenderimi nga Komiteti i Lanzarotit, duke i informuar poashtu se mendimet e fëmijëve do të integroheshin në krye të raportit të ardhshëm të Komitetit dhe që një kapitull i veçantë do t'i përmbledhonte kontributet e tyre. Përveç kësaj, mesazhet kyçe nga kontributi i tyre do të shënoheshin veçanërisht në kapitujt e tjerë të raportit dhe një numër i caktuar i rekomandimeve të Komitetit për Shtetet Anëtare do të bazoheshin veçanërisht në propozimet e fëmijëve që kontribuan në raport. Komiteti është duke planifikuar ta përgatisë një version të Raportit të përshtatshëm për fëmijë dhe t'i përfshijë fëmijët edhe në këtë proces.

II. Faza e legjislacionit për Qeverisjen e të Drejtave të Fëmijëve në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoni

Në aspektin legjislativ, Kosova qëndron relativisht mirë në Qeverisjen me të Drejtat e Fëmijëve. Kushtetuta e Kosovës e njeh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës është miratuar në 2020 dhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve (2019-2023) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj është hartuar brenda Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM), në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

Në Kosovë ekzistojnë mekanizmat monitorues në nivel lokal dhe kombëtar që duhet të përforcohen për të siguruar që të drejtat e fëmijëve janë duke u respektuar dhe mirëqenia e tyre është e garantuar. Sa i përket ndikimit të projektit në legjislacion, procesi i ndryshimit të Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje ka filluar, me qëllim që të përfshihen specifikat e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për ta lehtësuar identifikimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ofruesit e shërbimeve. Materialet e nxjerra iu kanë dorëzuar institucioneve përkatëse dhe tani me fillimin e ndryshimit të tyre, OSHC-të e mbështetura nga ky program janë duke avokuar për t'i përfshirë këto specifika.

Në **Kosovë**, sa i përket legjislacionit, aktualisht janë miratuar këto pako legjislative që promovojnë dhe garantojnë të drejta të barabarta për të gjithë fëmijët:

- *Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës nr. 06 / I-084,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 01/2021 për Mbrojtjen dhe trajtimin e delikuentëve të mitur nën moshën e përgjegjesisë penale,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 02/2021 për Zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative;*
- *Rregulloret komunale për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve,*
- *Rregulloret komunale për themelimin dhe strukturimin e asamblesë komunale të fëmijëve,*
- *Rregulloret komunale për realizimin e të drejtave, mbrojtjen dhe parandalimin e punës së rëndë për fëmijët,*
- *Rregullorja nr. 01/2019 për Procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët ose ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 03/2017 për Ulësen e sigurisë për fëmijë,*
- *Rregullorja nr. 04/2016 për Vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 01/2016 për Ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 12/2012 për Përbërjen dhe funksionimin e panelit për vendosjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në strehim familjar dhe adoptim,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 19/2016 për Përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë,*
- *Rregullorja 01-110-85291 për Mbrojtjen e fëmijëve nga veprimet që e dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre,*
- *Udhëzimi Administrativ nr. 09/2014 për Rregulloren e procedurave të adoptimit për fëmijët pa kujdes prindëror,*
- *Ligji nr. 03 / I-022 për Mbështetje materiale për fëmijët e familjeve me aftësi të kufizuara të përhershme,*
- *Ligji nr. 03 / I-212 i Punës,*
- *Ligji nr. 02 / I-17 për Shërbimet sociale dhe familjare (aktualisht nën rishikim për përfshirjen e Grantit Specifik për Shërbime Sociale)*
- *Ligji nr. 03 / I-189 për Administratën shtetërore të Kosovës,*
- *Ligji nr. 2004 / 4 për Shëndetësinë,*
- *Ligji nr. 02 / I-52 për Arsimin parashkollor,*
- *Ligji nr. 03 / I-040 për Vetëqeverisjen lokale,*
- *Ligji nr. 2004/32 i Kosovës për Familjen,*
- *Kodi nr. 06 / I-074 Kodi Penal i Kosovës,*
- *Kodi nr. 06 / I-006 i Drejtësisë për të mitur*

Qeveria e **Kosovës** është në proces të hartimit të 16 akteve nënligjore/udhëzimeve administrative të dala nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës

Serbia ende nuk e ka Ligjin gjithëpërfshirës për të Drejtat e Fëmijës dhe për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, si dhe nuk e ndalon qartë ndëshkimin trupor të fëmijëve në mjedisin familjar. Këto fakte të rëndësishme rezultojnë në mos-sinkronizim të aktiviteteve që synojnë përmirësimin e pozitës së fëmijëve në shoqëri. Miratimi i këtyre ligjeve është poashtu i rëndësishëm, pasi që ky është një rekomandim që institucioneve udhëheqëse të Serbisë ia ka dhënë Komiteti i Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve në dy cikle dhe nga Rishikimi i Tretë Periodik Universal i OKB -së i Këshillit të OKB -së për të Drejtat e Njeriut.

Plani Kombëtar i Veprimit për Fëmijët ka skaduar në vitin 2015 dhe Këshilli i të Drejtave të Fëmijëve i Qeverisë së Serbisë ka filluar procedurën për themelimin e Grupit Punues (GP) për hartimin e Strategjisë së re në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe Planit të saj të Veprimit. GP u formua në 2018 dhe Drejtori i Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve është njëri prej anëtarëve të këtij grupi. Procesi i hartimit të dokumentit të Strategjisë së re nuk ka filluar ende për shkak të mungesës së mbështetjes financiare. Anëtarët e GP kanë pasur një takim këshillues me Sekretariatën për Politika Publike të Republikës së Serbisë në 2019 për ta përcaktuar konceptin dhe hapat konkret për hartimin e Strategjisë së re në përputhje me Ligjin e sapomiruar për Sistemin e Planifikimit në Republikën e Serbisë.

Në 2020, Qeveria e Serbisë miratoi Strategjinë Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna për periudhën 2020-2023 me Planin e Veprimit për vitet 2020 dhe 2021. Ky dokument është një hap i rëndësishëm në procesin e përmirësimit strategjik të mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna në Serbi, sidomos duke pasur parasysh që Strategjia paraprake Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna mbulonte periudhën 2009-2015. Strategjia përcakton lloje të ndryshme të dhunës dhe, për dallim nga Strategjia paraprake, e njej një numër të gjerë mjedisesh në të cilat ndodh dhuna. Në këtë kontekst, kjo Strategji poashtu përcakton që ndëshkimi trupor i fëmijëve, me qëllimin e ndryshimit ose kontrollimit të sjelljes së tyre, është shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe që vendi ka zero tolerancë për ndëshkimin trupor.

Ky dokument poashtu e thekson rëndësinë e mbrojtjes së veçantë të fëmijëve nga grupet e cenuara që iu ekspozohen shpesh formave të shumta të dhunës, duke theksuar që veçanërisht grupet e cenuara të fëmijëve janë, mes tjerash, fëmijët në situatë rruge, fëmijët refugjatë, fëmijët emigrantë, fëmijët rom dhe fëmijët Lezbikë, Gej, Biseksual, Transgjinnor, Transseksual ose Interseksual (LGBTI). Megjithatë, Qeveria e Serbisë ende nuk e ka themeluar një Grup Punues për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, as nuk janë nominuar organizatat e shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë dhe për raportimin e zbatimit të saj. Është shqetësuese që zbatimi i Strategjisë nuk ka filluar ende duke marrë parasysh që dhuna ndaj fëmijëve dhe mbrojtja e tyre duhet të jetë prioritet në fushën e përmirësimit të të drejtave të fëmijës në Republikën e Serbisë. CRC do të vazhdojë së avokuari për zbatimin e vazhdueshëm të kësaj Strategjie.

Edhe pse është nënshkruar, Protokollin i Tretë Opsional për KDF në një Procedurë Komunikimi para Komitetit të të Drejtave të Fëmijëve nuk është miratuar ende. Rekomandimi i vetëm në lidhje me realizimin e të drejtave të fëmijëve që shteti i Serbisë e ka shënuar është ai në lidhje me Miratimin e Protokollit të Tretë Opsional. Si arsye për shënimin e këtij rekomandimi, duhet të theksohet që është e nevojshme të bëhen disa ndryshime në legjislacionin e brendshëm për ta mundësuar zbatimin efikas të tij dhe që për këtë arsye ky Protokoll nuk është miratuar dhe që, duke e nënshkruar atë, shteti i Serbisë ka treguar gatishmëri për ta pranuar. Gjatë vitit 2020, "Child Rights Centre" ka shfrytëzuar të gjitha mekanizmat dhe forumet për ta theksuar rëndësinë e miratimit dhe zbatimit të këtij Protokollin në Serbi. Këshilli i të Drejtave të Fëmijëve, si organi i vetëm qeveritar ndërsektorial i përbërë nga përfaqësues të ministrive përkatëse të linjës, OSHC-të dhe ekspertët e pavarur, nuk organizoi asnjë seancë në periudhën përgjatë 2020- 2021, specifikisht gjatë pandemisë COVID-19. Është veçanërisht shqetësuese që ky organ nuk ka arritur ta marrë asnjë veprim gjatë kësaj periudhe. Në 2021, u mbajt seanca konstituive dhe CRC është njëri prej 26 anëtarëve nga ministritë, institucionet, universitetet dhe organizatat e ndryshme joqeveritare. CRC vazhdon së avokuari për një rol më të fuqishëm të këtij Këshilli, pasi që ka autoritet të mjaftueshëm për t'i koordinuar të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e të gjitha të drejtave të fëmijëve. Rrjedhimisht, burimet njerëzore, teknike dhe financiare janë të domosdoshme për funksionimin e tij efektiv, meqenëse ky organ aktualisht ka vetëm rol këshillues.

CRC merr pjesë në seancat e Këshillit për Monitorimin e Zbatimit të Rekomandimeve të Mekanizmit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (Këshilli) brenda Ministrisë së të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave dhe e Dialogut Social (deri në zgjedhjet parlamentare në 2020, Këshilli ishte nën mandatin e Zyrës për të Drejtat e Njeriut dhe Pakicave). Ky këshill, si organ ndërministror, vazhdon ta monitorojë zbatimin e detyrimeve të ndërmarra nga Serbia në fushën e mbrojtjes dhe përmirësimit të situatës së të drejtave të njeriut. Gjatë vitit 2020, Këshilli nuk organizoi asnjë sesion dhe në vitin 2021 u mbajtën dy seanca. Në sesionin e mbajtur në shtator 2021, drejtori i CRC-së theksoi rëndësinë e themelimit të grupit punues tematik për mbështetjen e hartimit të raporteve periodike për zbatimin e KDF, që u mbështet nga anëtarët e Këshillit.

III. Barrierat ndaj pjesëmarrjes domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte, të fëmijëve në vendimmarrje në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut

Mungesa e përgjithshme e vetëdijes kolektive dhe institucionale për rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset demokratike dhe ushtrimin e rolit të shoqërisë civile shihet si faktor kyç që rëndon barrierat ndaj pjesëmarrjes domethënëse dhe të sigurt, direkte dhe indirekte, të fëmijëve në vendimmarrje në shtetet respektive. Buxhetimi i pamjaftueshëm i qeverive qendrore dhe komunale lidhur me realizimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në këto aktivitete karakterizon të githa këto shtete.

Barrierat tjera formale përfshijnë: mungesën e transparencës së mirëfilltë nga institucionet për t'i informuar palët për proceset që kanë për qëllim të diskutojnë ose zhvillojnë plane për komunat dhe ministritë; mungesën e vullnetit politik për të themeluar mekanizma të pjesëmarrjes së fëmijëve; mosgatishmërinë e institucioneve qendrore dhe lokale për t'i përfshirë fëmijët në proceset e vendimmarrjes që kanë ndikim në jetën e tyre; mosgatishmërinë e bartësve të detyrave të institucioneve për t'i ngritur kapacitetet e fëmijëve dhe qytetarëve për të pasur njohuri të mjaftueshme për proceset e vendimmarrjes; mungesën e kapaciteteve dhe mjeteve për të komunikuar me sukses me fëmijët, për t'i kuptuar këndvështrimet e tyre dhe për t'i dëgjuar pikëpamjet e tyre.

Si pasojë e mungesës së informatave nga bartësit e detyrave për orën, vendin, datën dhe mënyrën se si organizohen konsultimet me publikun, ka mungesë të pjesëmarrjes direkte ose indirekte të fëmijëve në vendimmarrje. Po ashtu, shoqëritë në shtetet pjesë e programit janë kryesisht patriarkale dhe rrjedhimisht, u kushtohet vëmendje e ulët pikëpamjeve të vajzave dhe faktorëve gjinor për barazi në vendimmarrje. Edhe pse disa politika dhe masa të konsiderueshme e mundësojnë pjesëmarrjen e fëmijëve, zëri i tyre nuk dëgjohet mjaftueshëm. Kjo rezulton në motivim të ulur të fëmijëve dhe të rinjve për t'u përfshirë në proceset e vendimmarrjes. Kjo barrierë është edhe më e theksuar në grupet më të ndjeshme, duke e bërë kështu nivelin e pjesëmarrjes së tyre edhe më të ulët. Mentaliteti dominues që fëmijët nuk mund të jenë mjaft të pjekur për të vendosur për veten vazhdimisht, përmes çdo parametri, sfidon pjesëmarrjen domethënëse të fëmijëve në vendimmarrje në çdo mjedis.

Veçanërisht në **Kosovë**, sfidë mbetet themelimi dhe funksionimi i Asambleve Komunale të Fëmijëve në të gjitha komunat e Kosovës, që do të kontribuonin në përmirësimin e pozitës së të rinjve në vendimmarrjen lokale dhe në krijimin e liderëve të ri lokalë.

IV. Ndikimi i COVID-19 në pjesëmarrjen e fëmijëve, duke përfshirë pjesëmarrjen online dhe implikimet afatgjata për pjesëmarrjen e fëmijëve në të ardhmen

Pandemia COVID-19 e ka zvogëluar shumë hapësirën e fëmijëve për zhvillim. Kjo pandemi ka pasur efekt negativ në sistemin e edukimit në përgjithësi dhe në të mësuarit në veçanti. Poashtu, pandemia ka ndikuar edhe në kufizimin e qasjes në shërbime esenciale, rrallimin e kontakteve sociale dhe mundësive të fëmijëve për t'i ndarë mendimet e tyre me vendimmarrësit. Pandemia COVID-19 e ka përkeqësuar edhe më shumë pozitën e fëmijëve, që reflektohet veçanërisht tek fëmijët nga grupet më të cenuara – fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët emigrantë, fëmijët rom, fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, fëmijët me HIV/AIDS, fëmijët LGBTI dhe fëmijët e tjerë në situata të ndjeshme.

Pa zgjidhje sistematike, pa një qasje strategjike dhe ndarje të mjaftueshme buxhetore për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve, qeveritë në shtetet respektive ishin të papërgatitura për t'iu përgjigjur nevojave të grupeve më të cenuara të fëmijëve. Gjatë periudhës së COVID-19, fëmijët u prekën më së shumti nga masat e ndërmarra nga autoritetet shtetërore për mbrojtje nga virusi COVID-19, por asnjëherë nuk u konsultuan ose nuk patën asnjë rol në vendimmarrje lidhur me ato masa.

Fëmijët me aftësi të kufizuara ishin grupi më i cenuar i ndikuar nga COVID-19. Sa i përket pjesëmarrjes online, mungesa e pajisjeve adekuate, mungesa e njohurive për përdorimin e platformave & pajisjeve të ndryshme, si dhe mungesa e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara e ka bërë pothuajse të pamundur që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në shkollë dhe aktivitetet e tjera.

Shumica e tyre nuk i kanë ndjekur mësimet fare për periudha të caktuara kohore, duke përjetuar kështu kufizime të dukshme në qasjen në edukim si dhe rënie në progresin e tyre edukativo-arsimor, por edhe në socializimin e tyre me të tjerët. Mungesa e kontaktit me bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit e ka thelluar dhe rënduar edhe më shumë izolimin social të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe e ka penguar pjesëmarrjen e tyre në procese vendimmarrëse.

Qasja në internet për disa fëmijë ka qenë e pamundur dhe për shumë prej tyre e vështirë. Kjo ka ndikuar negativisht tek ta duke kufizuar qasjen e tyre në mësim online. Poashtu, mungesa e pajisjeve teknologjike dhe qasjes në internet ua ka pamundësuar fëmijëve në situata të ndjeshme dhe në zona të largëta t'i ndjekin mësimet. Kjo ka ndikuar në mosrealizimin e të drejtave të tyre gjatë kësaj periudhe.

REKOMANDIME

Sipas pjesëmarrësve në hulumtim, rekomandimet kryesore për përforcimin e proceseve, mekanizmave dhe platformave për pjesëmarrje më sistematike, domethënëse dhe gjithpërfshirëse të fëmijëve në Kosovë, Moldavi, Ukrainë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut përfshijnë:

- Të krijohet një mjedis ku të gjithë fëmijët janë të fuqizuar për ta shprehur mendimin e tyre lirshëm dhe për t'u ndjerë të sigurtë e të mbrojtur në çdo mjedis;
- Të promovohet zbatimi i proceseve të llogaridhënies brenda institucioneve që përqendrohen tek interesi më i mirë i fëmijës;
- Të lobohet me vendimmarrësit për ta institucionalizuar pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha nivelet;
- Të krijohen platforma elektronike për pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje;
- Të fuqizohen këshillat e fëmijëve, asambltetë e fëmijëve, parlamentet e fëmijëve dhe klubet e ndryshme të fëmijëve dhe të rinjëve;
- Të informohen fëmijët drejtpërdrejt për proceset e vendimmarrjes nga komuna dhe institucionet tjera duke përdorur mediat sociale;
- Të punohet drejtpërdrejt me fëmijët dhe të angazhohen në dëgjime/konsultime publike dhe aktivitete të tjera praktike që e promovojnë pjesëmarrjen dhe llogaridhënien;
- Të rritet vetëdija dhe të ngriten kapacitetet e ofruesve të shërbimeve për të drejtat e fëmijëve për pjesëmarrje në vendimmarrje;
- Të përcaktohen njësitë/zyrtarët përgjegjës në nivel kombëtar dhe lokal që do të komunikojnë me fëmijë;
- Të zhvillohen mekanizma funksional të mbledhjes së komenteve vlerësuese dhe rekomandimeve të fëmijëve brenda institucioneve edukativo-arsimore, shëndetësore dhe të mbrojtjes së fëmijës;
- Të zhvillohen mjete të komunikimit për institucionet e pavarura dhe profesionistët e të drejtavë të fëmijëve në kontakt me fëmijë;
- Reformat në arsim të synojnë ta rrisin kapacitetin për të ofruar arsim gjithpërfshirës dhe cilësor për aftësi të ndryshme për punë dhe jetë, që do të shpiejnë në pozitë më të favorshme për të gjithë fëmijët në shoqëri dhe kështu në përmirësimin e pjesëmarrjes që do të jetë një proces i vazhdueshëm, nga fëmijëria në maturinë.



Save the Children

Rr: Gazmend Zajmi, nr 01

10000 Prishtinë, Kosovë

Telefon: +383 (0) 38 23 26 91

Fax: +383 (0) 38 23 26 93

Email: scik@savethechildren.org

Facebook [@savethechildrenkosovo](https://www.facebook.com/savethechildrenkosovo)

Instagram [@savethechildreninkosovo](https://www.instagram.com/savethechildreninkosovo)

Twitter: [@SCinKosovo](https://twitter.com/SCinKosovo)